



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 1298/ 8 Prot.

Tiranë, më 17.04.2018

V E N D I M

Nr. 25, Datë 17.04.2018

PËR

AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË KAMËZ ME OBJEKT “MBI AUDITIMIN E RREGULLSHMËRISË FINANCIARE NË AKTIVITETIN EKONOMIK” për periudhën 01.01.2016 deri 31.12.2017 për bashkinë Kamëz dhe 01.07.2014 deri 31.07.2015 për ish komunën Paskuqan

Nisur nga fakti që nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Kamëz, rezultoi të këtë në disa raste devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret), një pjesë e të cilave i përkasin ish Komunës Paskuqan, pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e rregullshmërisë financiare në aktivitetin ekonomik” të ushtruar në Bashkinë Kamëz, sipas programit të auditimit nr. 1298/1 prot, datë 15.12.2017 për veprimtarinë nga data 01.01.2016 deri më datën 31.12.2017 dhe për ish Komunën Paskuqan për veprimtarinë nga data 01.07.2014 deri më datën 31.07.2015.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të konsoliduar të Bashkisë Kamëz për periudhën e viteve 2015, 2016 dhe 2017, përfshihen edhe të dhënat e pasqyrave financiare të ish Komunës Paskuqan për

periudhën e aktivitetit janar-31 korrik 2015, në zbatim të reformës administrative dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”.

Konkretisht, në pasqyrat financiare të Bashkisë Kamëz, janë bartur disa pasaktësi të konstatuara nga auditimi i pasqyrave financiare të ish Komunës Paskuqan:

-Llogaria e aktivitetit të bilancit 202 “*Shpenzime për studime ose kërkime*”, për vlerën e debisë 18,334,227 lekë, në analizë të saj, është evidentuar vlerën e shpenzimeve për studime projektimi dhe oponenta teknike të kryera në vite. Për këto aktive, nuk janë hapur kartela inventariale për personat që i kanë në ngarkim dhe i administrojnë këto studime dhe projekte.

Vlera e studimeve dhe projekte, për investimet e përfunduara, nuk janë kontabilizuar në debi të objekteve të përfunduara.

-Llogari 210 “*Toka, troje, terrene*” për vlerën e debisë 718,946 lekë, nuk disponohen të dhëna analitike dhe inventariale mbi përmbajtjen e kësaj llogarie.

-Llogaria 213, “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” me vlerën kontable 1,087,458,530 lekë. Kjo vlerë është e analizuar sipas objekteve për vlerën 1,088,177,476 lekë. Në këtë rast, për diferencën (1,088,177,476-1,087,458,530)= 718,946 lekë kjo llogari nuk është e analizuar sipas objekteve.

-Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” me vlerën kontabël 95,823,904 lekë.

Kjo llogari është e analizuar sipas subjekteve, objekteve, faturave dhe vlerave përkatëse, përveç në 4 raste për vlerën 473,299 lekë, për të cilat mungon dokumentacioni i nevojshëm kontabël ligjor.

Përsa më sipër, janë shkëlqej të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar, nenet 7, 9 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap. III pikat 26, 35/b, 35/c dhe kap IV, pika 73 dhe VKM nr. 510, datë 10.6.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorial”, Kreu III, pika 1 dhe Kreu VI, pika 2 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, kap. I, pika 2 (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat, të procedojë sipas kërkesave ligjore për të sistemuar kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me qëllim që ato të pasqyrojnë gjendjen reale të aktiveve të Bashkisë Kamëz dhe të organizojnë evidencën e inventarit të studimeve dhe projekteve të investuara në vite. Administrimi i studimeve dhe projekteve, të bëhet sipas procedurave ligjore duke hapur kartela inventari, në ngarkim të personave që i kanë në administrim.

Brenda muajit qershor 2018

2. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 01.01.2016 deri më datë 31.12.2017, punonjësit e larguar nga puna nga Bashkia Kamëz dhe ish-Komuna Paskuqan, janë paguar sipas vendimeve të Gjykatës së Apelit Tiranë, në **vlerën 4,762,578 lekë për 7 ish punonjës** me efekte negative në buxhetin e Bashkisë. Çështjet gjyqësore, nuk janë ndjekur në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ Tiranë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12 pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, të marrë masat që në të ardhmen, të ndjekë në të gjitha shkallët e gjykimit çështjet gjyqësore me kreditor Bashkinë Kamëz.

Në vijimësi

3. Nga Bashkia Kamëz, përgjithësisht janë implementuar kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, por në përpilimin e raportit vjetore dhe të deklaratës mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017, dërguar Ministrisë së Financave, nuk është marrë informacion nga Drejtoritë e Administratës, në kundërshtim me pikën 15, germa b, të UMF nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike” (*trajtuar më hollësisht në faqet 10-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Bashkia Kamëz të marrë masa, të dërgoj në Ministrinë e Financave deklaratën, pyetësoarin dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

a. Në Bashkinë Kamëz, në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 Subjekte të biznesit të madh për të cilat llogaritet mungesë të ardhurash **në vlerën 49,781,264 lekë**. (Nga të cilat për vlerën 5,016,666 lekë, nga ish Komuna Paskuqan)

b.Nga auditimi mbi vjeljen e detyrime për tatim taksat lokale, konstatohet se nga Bashkia Kamëz, nuk janë marrë masa të veçanta lidhur me vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën prej **285,035,451 lekë**, për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria e Tiranës.

Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Kamëz, konstatohet se nga muaji Qershor i vitit 2014, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifën përkatëse 4,226 persona për sipërfaqe ndërtimore të legalizuar gjithsej 900,908 m² nga të cilat 841,739 m² për banim dhe 59,168 m² për aktivitet social ekonomik.

Vlera totale e pa arkëtuar është **285,035,451 lekë, e ardhur e munguar** nga të cilat 130,020,768 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 155,014,683 lekë tarifa për planet vendore.

c.Në Bashkinë Kamëz, kanë ushtruar aktivitet 45 subjekte pa qenë të regjistruar në QKB, për të cilat llogaritet **mungesë të ardhurash në vlerën 2,082,685 lekë**, (Bashkia Kamëz, për 54 subjekte në vlerën 1,976,251 lekë, Njësia Administrative Paskuqan, për 10 subjekte në vlerën 106,434 lekë).

Përsa më sipër, nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.20106, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar me nr. 50/2014 neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar”, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimi” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 140 datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore të bashkisë për vitin 2017”.

Drejtoria e Tatim Taksave Bashkia Kamëz për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore dhe taksës ndikimit në infrastrukturë, nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 40, 41 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12, të UMF nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve” (trajtuar më hollësisht në faqet 125-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Kamëz, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar të marrë masat për arkëtimin e detyrimeve tatimore duke bërë njoftim vlerësimet tatimore:

-për 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 Subjekte të biznesit të madh debitorë **në shumën 49,781,264 lekë** dhe

-për 4,226 persona në vlerën totale të pa arkëtuar prej **285,035,451 lekë, e ardhur e munguar** nga të cilat 130,020,768 lekë taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 155,014,683 lekë tarifa për planet vendore.

Duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Tu dërgohen bankave (subjekteve që nuk u është dërguar) urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b- Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c- Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 %, kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

4.2. Rekomandimi: Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Kamëz të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore duke kërkuar regjistrimin në QKB të 45 subjekteve dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën **2,082,685 lekë**.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në vitet 2016, dhe 2017, Bashkia Kamëz, ka financuar shoqërinë “F..... a” SHA në shumën **50,370,000 lekë** nga të cilat në vitin 2016 në shumën 18,700,000 lekë dhe në vitin 2017 në shumën 31,670,000 lekë për “funksionimin dhe mbarëvajtjen e ekipit”.

Shoqëria “F..... a” SHA ka për aktivitet sportin e futbollit, në të cilën Bashkia Kamëz, është aksionare në masën 49% të aksioneve ndërsa 51% të aksioneve i ka shoqëria “Q.....2” SHPK.

Alokimi i fondeve, është bërë sipas miratimit me Vendime të Këshillit të Bashkisë dhe Vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë në datat 06.01.2016 dhe datë 4.01.2017.

Nga Bashkia Kamëz, nuk na u paraqitën të dhëna nëse edhe shoqëria “Q..... 2” SHPK, ka përmbushur detyrimet e saj ndaj shoqërisë “F..... a” SHA, në raport me pjesëmarrjen në aksione për vlerën 52,425,918 lekë, sipas miratimeve me Vendime të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 25, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” nenet 10/2, 40/2 dhe 76 si dhe të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” nenet 3, 4 (trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz, si pjesëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë “F..... a” SHA, të mos financojë në vijim shoqërinë “F..... a” SHA, nëse edhe ortaku tjetër shoqëria “Q..... 2” SHPK, nuk paraqet dokumenta financiare që të vërtetojë se ka përmbushur detyrimet e veta financiare si dhe të kërkojë auditim mbi përdorimin e fondeve të alokuara.

Menjëherë

6.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz, si pjesëtare e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë “F..... a” sha, të kërkojë auditim mbi përdorimin e fondeve të alokuara nga kjo Shoqëri gjatë viteve 2016-2017 dhe përmbushjen e detyrimeve financiare nga ortaku Shoqëria “Q.....2” shpk për vlerën 52.425.918 lekë, në përmbushje të kërkesave ligjore dhe Vendimeve të Asamblesë së Aksionarëve.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e pasqyrave financiare të Bashkisë Kamëz për vitin 2017, gjendja e debitorëve, llogaria 468, është në shumën 158,258,018 lekë e analizuar për 596 subjekte nga të cilat;

-97,427,000 lekë ose 61,5% e totalit, janë debitorë 242 subjekte për vlerën e gjobave të vendosura nga IVMT e të pa arkëtuara,

- 52,225,145 lekë ose 33% e totalit janë subjekte debitorë për tatim taksat lokale për periudhën e viteve 2007-2017,

-8,605,873 lekë ose 5,5 % e totalit janë debitorë të tjerë.

Gjendja e kreditorëve, llogaritë 401-408, është në shumën 504,748,856 lekë, që përfaqësojnë detyrimet për faturat dhe situacione të pa paguara, pra borxhi i bashkisë ndaj të tretëve, e cila është shumë më e madhe se sa kërkesat ndaj debitorëve për diferencën (504,748,856- 158,258,018) 346,490,838 lekë.

U konstatua se në detyrimet kreditore, nuk është kontabilizuar si detyrim në 1 rast vendimi i Gjykatës së Apelit nr. 30-2014-7135, datë 25.11.2014, me detyrim Bashkinë Kamëz për ti paguar Subjektit “A..... 6” shpk, shumën 4,265,737 lekë nga të cilat 3,576,000 lekë principal dhe 689,737 lekë janë interesat bankare dhe kamatat ligjore, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8116 datë 29.3.1996 “Kodi procedurës civile” i ndryshuar nenet 130, 131, 316 dhe ligjit nr. 7850 datë 29.7.1994 “Kodi Civil” i ndryshuar neni 850. Në këtë rast, Bashkia Kamëz ka kontabilizuar vetëm detyrimin për principalin, për të

cilën ka ngelur pa paguar vlera për 1,403,200 lekë, kurse detyrimin për interesat dhe kamatat ligjore, nuk janë kontabilizuar dhe as janë paguar (trajtuar në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike e Bashkisë Kamëz, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, të procedojnë në rrugë ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat lokale si dhe të marrë masat e nevojshme uljen e detyrimeve për fatuarat e pa paguara me qëllim për përmirësimin e gjendjes financiare si dhe të merren masa, për kontabilizimin dhe pagesën e detyrimit financiar ndaj subjektit “ALFA –PROJEKT 2006” shpk, në zbatim të vendimit të Gjykatës së Apelit nr. 30-2014-7135, datë 25.11.2014.

7.2 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 242 vendime me gjobë për ndërtimet e pa ligjshme, të vendosura para vitit 2016 në vlerën **97,427,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”. Njëherazi të marrë masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*Sipas Pasqyrës administron IMTV Bashkia Kamëz*).

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi aktivitetin e Ndërmarrjes së Ujësjellës Kanalizimeve që është në vartësi të Bashkisë Kamëz, konstatohet performancë e ulët në vjeljen e detyrimeve nga abonentët:

-**Për vitin 2016**, të ardhurat janë realizuar në masën 155,423 mijë lekë ose 68% e programimit. Numri i abonentëve gjithësej është 15,968 abonentë, kurse gjendja e debitorëve është 6,698 abonentë për vlerën 85,826 mijë lekë.

-**Për vitin 2017**, të ardhurat janë realizuar në masën 197,538 mijë lekë ose 66% e programimit. Numri i abonentëve gjithësej është 22,519 abonentë, kurse gjendja e debitorëve është 4,364 abonentë për vlerën 84,333 mijë lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 153-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve, të merren masat e nevojshme për arkëtimin e plotë të detyrimeve debitorë, duke hartuar programe pune, lajmërimin e abonentëve debitorë dhe masa të tjera administrative.

Në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vjeljen e taksës për mjetet në përdorim, ku sipas ligjit, agjent tatimor është Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), konstatohen parregullsi për vlerat e xhiruara për Bashkinë Kamëz.

Sipas korrespondencës shkresore që Bashkia Kamëz, ka pasur me DPSHTRR-në për pasaktësitë e pretenduar për masën e taksës për mjetet në përdorim të xhiruara, konstatohen të dhëna kontradiktoret, konkretisht:

Numri i mjeteve të transportit në Bashkinë Kamëz për vitin 2016 është 12,009 mjete kurse për vitin 2017 është 13,224 mjete, ndërsa janë i janë xhiruar të ardhura Bashkisë Kamëz për 972 mjete në përdorim.

Llogaritjet që nga DPSHTRR-ja, ti jenë xhiruar më pak të ardhura nga taksa e mjeteve në përdorim gjithësej 62,306,673 lekë, nga të cilat në vitin 2016 për 32,332,213 lekë dhe në vitin 2017 për 29,974,460 lekë,

Mungesë bashkëpunimi institucional konstatohet edhe midis Bashkisë Kamëz dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave lidhur me vlerën e vjeljes dhe xhimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për Bashkinë Kamëz.

Konkretisht, në vitin 2016 Drejtoria e Përgjithshme e Tatim Taksave i ka xhiruar Bashkisë Kamëz 11,722,952 lekë duke pasur të regjistruara me aktivitet 2750 subjekte, kurse në vitin 2017 i ka xhiruar 3,214,084 lekë duke pasur të regjistruara 2870 subjekte pra 120 subjekte më shumë se në vitin 2016.

Në këtë rast, mos akordimi institucional, është shkelje e kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.” nenet 17, 18, 19, UMF nr. 32, datë 31.12.2013 “Për tatimin e thjeshtuar të fitimit për biznesin e vogël”, ligjit nr. 8308, datë 13.08.1998 “Për transportet rrugore” ndryshuar; ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare” i ndryshuar, si dhe të pikës 3, neni 63, të ligjit nr. 68/2017 “Përfinancat e vetëqeverisjes vendore” (*trajtuar më hollësisht në faqet 127-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kamëz, të merren masa duke rakorduar të dhënat zyrtare mbi mjetet në përdorim me DPSHTRR-në me qëllim vjeljen e kësaj takse në masën sipas ligjit si dhe të rakordohen të dhënat zyrtare të Bashkisë Kamëz dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatim Taksave (DPTT) lidhur me tatimin e thjeshtuar të fitimit, në zbatim të kërkesave ligjore të sipër cituara.

Në rast të mosmarrëveshjeve institucionale të pa zgjidhura në rrugë administrative, të procedohet me kërkesë padi në gjykatë ndaj DPSHTRR dhe DPTT për vjeljen e taksës së mjeteve në përdorim dhe tatimit të thjeshtuar të fitimit.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e reformës administrative dhe kërkesave të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore,” i ndryshuar, nenet 21, 22, dhe 95 pika 3, ku citohet: “*Funksionet e reja, që u transferohen bashkive me këtë ligj, për një periudhë deri në tre vjet, do të financohen nga buxheti i shtetit me transferta specifike, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin vjetor të Buxhetit të Shtetit*”, konstatohet se nga qeveria qendrore i janë deleguar Bashkisë Kamëz disa funksione të reja të cilat nuk janë shoqëruar me financime buxhetore.

Kjo gjë ka ndikuar në përmbushjen të misionit të qeverisjes vendore, **konkretisht për funksionet:**

-Referuar shkresës së Shërbimit Social Shtetëror nr. 2189 prot., datë 23.10.2015 “Për kalimin e Qendrës Polivalente në administrim të Bashkisë Kamëz”, ky objekt dhe shërbim i ka kaluar Bashkisë Kamëz, por marja në dorëzim të këtij objekti, nuk është bërë dhe nuk është shoqëruar çeljen e fondeve përkatëse për kryerjen e këtij funksioni.

-Në zbatim të ligjit nr. 152/2015 “Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi” pranë njësive vendore është transferuar funksioni i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi por kjo nuk është shoqëruar me logjistikën e duhur si stacione zjarrfikëse, automjete dhe pajisje etj.

-Pranë Bashkisë Kamëz, është transferuar edhe funksioni i administrimit të pyjeve dhe kullotave, në zbatim të VKM-në nr. 433, date 08.06.2016, por kjo nuk është shoqëruar me çelje fondesh për mire administrimin e tyre.

-Pranë njësive vendore është transferuar edhe funksioni i administrimit të Ujitjes dhe Kullimit për të cilën pretendohet se fondet e çelura janë minimale Kjo gjë nuk mundëson në krijimin e strukturave për administrimin e shërbimeve të ujitjes dhe kullimit.

Nga Korriku i vitit 2015 e në vazhdim, në administrim të Bashkisë Kamëz, në zbatim të ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është përfshirë ish Komuna Paskuqan sot Njësi Administrative e Bashkisë.

Nga krahasimi i disa treguesëve **para reformës** administrative-territoriale, datë 31.12.2014 **dhe pas reformës** datë 31.12.2017, rezultojnë këta tregues:

Numuri total i punonjësve për ish Komunën Paskuqan dhe Bashkinë Kamëz, në fund të vitit 2014 ishte 385 punonjës, kurse në fund të vitit 2017, numri i punonjësve në Bashkinë Kamëz, ishte 371 punonjës, pra zvogëluar me 14 punonjës por fondi i pagave është rritur me 39,592,975 lekë në vit.

Shpenzimet operative janë zvogëluar 16,618,342 lekë, numri i subjekteve tatim pagues është rritur me 652 subjekte kurse të ardhurat lokale janë rritur me 231,076,864 lekë (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52, 153-165 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandim: Bashkia Kamëz, të bashkëpunojë me strukturat e qeverisë qendrore për financimin e funksioneve të reja që i janë deleguar, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore,” i ndryshuar, nenet 95, 10- Marrëdhëniet midis qeverisë qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, 11- Komunikimi dhe informimi dhe 12- Konsultimi midis qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.

Vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e dosjeve të lejeve zhvillimore të miratuara, u konstatuan mangësi në plotësimin e dokumentacionit si dhe ekzistenca e dokumenteve fotokopje të pa noterizuara.

Praktikat për miratimin e lejeve zhvillimore të dërguara për miratim te Kryetari i Bashkisë, nuk janë shoqëruar me relacion tekniko-ligjor dhe projekt-vendimin, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 107,

datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar (*trajtuar në faqen 142-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit, të marrë masa që në momentin kur subjektet të aplikojnë për Certifikatë Përdorimi përveç të tjerave t’ju kërkojnë subjekteve, sipas rastit, edhe plotësimin e mangësive të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe më pas të lëshojnë Certifikatën e Përdorimit, në zbatim të ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar dhe VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar.

11.2. Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit Zhvillimit Territorit, të marrë masa për hartimin dhe plotësimin e praktikave të lejeve zhvillimore me relacion tekniko-ligjor dhe projekt-vendimin për miratimin e lejes zhvillimore rast pas rasti.

Në vazhdimësi

12. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Kamëz, nuk ka arkëtuar gjobat për shkeljet e konstatuara në ndërtimet pa leje ndërtimi, si dhe nuk ka ndjekur në rrugë ligjore me padi në gjykatë për 140 raste në vlerën 54,933,000 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara të paplanifikuara në buxhetin e Bashkisë, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” nenet 20, 30 dhe ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar (*trajtuar hollësisht në faqet 142-152 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike të marrë masat dhe të kërkojë në Gjykatë rivendosjen në afat për 140 vendime me gjobë për ndërtimet e kundërligjshme, të vendosura gjatë vitit 2017 në vlerën **54,933,000 lekë**, bazuar në nenet 151 dhe 152, të “Kodit Procedurës Civile në RSH”.

Njëherazi të marrë masa për kthimin e vendimeve të gjobave në tituj ekzekutiv në zbatim të nenit 24-Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (*Sipas Pasqyrës administron IMTV Bashkia Kamëz*).

Menjëherë

13. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Kamëz, nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Tiranë, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar (*trajtuar në faqe 152-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Kamëz.

Brenda muajit Korrik 2018

14. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim Bashkia Kamëz. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik (*trajtuar në faqe 152-153 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi: Bashkia Kamëz, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Tiranë në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Brenda muajit Korrik 2018

15. Gjetje nga auditimi: Në 6 investimet e audituara në Bashkinë Kamëz, me vlerë totale të kontratave 241,256,058 lekë me tvsh nga verifikimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjet teknike si dhe nga verifikimi në terren, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën 814,122 lekë pa tvsh si dhe mangësi në dokumentacion. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 7 dhe 12 të ligjit nr. 8402 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1 datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika b, nr. 3.3 paragrafi i dytë, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, pika 8.1 dhe 8.3, Vendimin Nr. 514 të Këshillit të Ministrave, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, pika 9 dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4 (trajtuar më hollësisht në faqet 52-127 të Projekt Raportit të Auditimit).

15.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kamëz, të merren masa për monitorimin e vazhdueshëm të investimeve, si gjatë periudhës së zbatimit të punimeve ashtu edhe në përfundim të tyre. Dosjet teknike të objekteve të përfunduara të merren në dorëzim nga zyra e autorizuar sipas Rregullores së Brendshme të Bashkisë vetëm pas plotësimit të tyre në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011, pika, 4 paragrafi 4.

Vazhdimisht

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit publik për periudhën objekt auditimi u konstatua se dosjet e procedurave të prokurimit nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh në kundërshtim me udhëzimet e APP-së, nenin 30 të Modelit nr. 8 “Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të nenit 3 e 29 të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz, të marrë masa për sistemimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, inventarizimit dhe arkivimit të tyre, sipas lidhjeve dhe në mënyrë kronologjike.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nuk janë zbatuar plotësisht masat e rikërkua nga KLSH-ja me shkresën nr. 489/10 prot., datë 30.06.2014.

Nga 4 masa organizative të rikërkua për tu zbatuar për arkëtimin e detyrimeve debitore nga dy subjekte në shumën 500,000 lekë si dhe arkëtimin e detyrimeve nga tatim taksat lokale nga 971 subjekte për shumën e detyrimeve 62,711,784 lekë, janë realizuar ose janë në proces zbatimi:

Është arkëtuar nga një subjekt shuma 450,000 lekë, ngelet pa arkëtuar diferenca 50,000 lekë nga mbikëqyrësi i punimeve të objektit “Ndërtimi i rrugës Mërkuri”, kurse arkëtimi i detyrimeve nga tatim taksat vendore është në proces zbatimi.

Nga 9 masa për shpërbllim dëmi, për arkëtimin nga 195 subjekte të vlerës 4,514,649 lekë, rezultoi se janë zbatuar plotësisht 5 masa duke arkëtuar nga 190 subjekte vlerën 3,667,048 lekë, ngelen pa zbatuar 4 masa për arkëtimin nga 5 subjekte shumën 847,601 lekë (trajtuar më hollësisht në faqet 6-10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kamëz, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me prioritet zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshmërinë e nëpunësve shtetërore. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuar, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të

siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e bashkisë. Të zbatohen plotësisht rekomandimet e perealizuara dhe rikërkua nga KLSH-ja me shkresën nr. 489/10 prot., datë 30.06.2014.

Menjëherë

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, **nga Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 3,375,978 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në vitin 2015, nga ish Komuna Paskuqan, janë paguar nga fondi i veçantë shpërblime për punë të mirë gjithsej **427,102 lekë për 11 punonjës me dëm ekonomik**, në kundërshtim me VKM nr. 849, datë 6.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar pika 9 (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Kamëz, të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës **427,102 lekë** nga 11 persona përfitues sipas listës emërore në fq. 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda Muajt Maji 2018

2. Gjetje nga auditimi: U konstatua se për vitin 2016 dhe 2017, nga Drejtoria e Tatim Taksave, janë aplikuar tarifa për taksat për biznesin e vogël (taksë pastrimi, taksë ndërtese, taksë gjelbërimi), më të ulta se sa janë miratuar në paketën fiskale me Vendime të Këshillit të Bashkisë me efekt **dëm ekonomik për vlerën 2,134,754 lekë**, nga të cilat:

- 440,000 lekë në vitin 2016 në 27 raste dhe

- 1.694.754 lekë në vitin 2017 (*trajtuar më hollësisht në faqet 125-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Kamëz të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit me qëllim kërkimin për shpërblimin e **dëmit me vlerën 2,134,754 lekë**.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim rruga Demokracia Loti II” Kamëz, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **213,500 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 435 prot datë 31.10.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE “E..... T” Sh.p.k. (*trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **213,500 lekë pa t.v.sh** nga operatori ekonomik “E..... T” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 435 prot datë 31.10.2016 me objekt “Ndërtim rruga Demokracia Loti II” Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim rruga Paskuqan 2, Vreshtë” Kamëz, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **88,550 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 315 prot datë 26.07.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “N..... I” Sh.p.k dhe “N..... I” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **88,550 lekë pa t.v.sh** nga operatorët ekonomikë “N..... I” Sh.p.k dhe “N..... I” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 315 prot., datë 26.07.2016 me objekt “Ndërtim rruga Paskuqan 2, Vreshtë” Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim KUN Paskuqan 1 dhe Rruga Ibrahim Rrugova” Kamëz, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **421,080 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 380 prot., datë 15.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE “S..... F” Sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **421,080 lekë pa t.v.sh** nga operatorët ekonomikë “S..... F” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 380 prot datë 15.09.2016 me objekt “Ndërtim KUN Paskuqan 1 dhe Rruga Ibrahim Rrugova” Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në objektin “Ndërtim rruga Paskuqan 2, Vreshtë” Kamëz, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në vlerën **90,992 lekë pa t.v.sh** si pasojë e likuidimit të punimeve të kryera në fakt. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 300 prot., datë 15.07.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe BOE “N..... I” Sh.p.k dhe “N..... I” sh.p.k. (trajtuar më hollësisht në faqet 19-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandim: Nga Bashkia Kamëz të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **90,992 lekë pa t.v.sh** nga operatorët ekonomikë “N..... I” Sh.p.k dhe “N..... I” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 300 prot datë 15.07.2016 me objekt “Ndërtim rruga Paskuqan 2, Vreshtë” Kamëz, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera në fakt apo prej mos ndryshimit të zërave në situacion sipas zërit faktit.

Menjëherë

B.2 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Në auditimin e procedurave të prokurimeve, të zhvilluara në Bashkinë Kamez, u konstatua se **6 procedura prokurimi** janë kryer në kundërshtim me nenin 2, “Parimet e përzgjedhjes”, nenin 55, “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, nenin 24, “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe pika 5 e nenit 53,

“Shqyrtimi i ofertave”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi:

Operatorët ekonomikë janë shpallur fitues edhe pse kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur sipas kërkesave të DST, të miratuara nga Autoriteti Kontraktor (këtu e në vijim AK) dhe Njësia e Hartimit të Dokumenteve të Tenderit (këtu e në vijim NJHDT), duke mos anuluar këto procedura, veprime këto me impakt negativ në buxhet për procedurat e prokurimit të shpallura fituese në **vlerën totale të fondit limit 327,217,590 lekë, me efekt në shumën 35,092,429 lekë që përfaqësojnë mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve, të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në kundërshtim me dispozitat e ligjit të prokurimit publik dhe shpallur fitues me kritere të paplota e konkretisht sipas tenderëve më poshtë:**

1. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim rruga “Liria” Frutikulturë dhe rrethrotullim”**, me fond limit 66,668,100 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “K..... n” shpk & “V..... E” shpk, me vlerë 65,287,867 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën **11,964,644 lekë**, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur fituese të BOE “K..... n” shpk & “V..... E” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar të OE “G..... n” SHA (65,287,867- 53,323,223) = 11,964,644 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim rruga Abdi Bej Toptani”**, me fond limit 76,026,526 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “E..... t” shpk & “K..... s” shpk, me vlerë 74,918,970 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 2,799,160 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e shpallur padrejtësisht fituese të BOE “E..... t” shpk & “K..... s” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar të OE “B..... B” shpk, me vlerë 72,119,810 lekë (74,918,970 - 72,119,810) = 2,799,160 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Ndërtim rruga Demokracia III (Aksi Ura Babrru-Ura Babrru, Fushë Kerçik)”**, me fond limit 44,167,408 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S..... F” shpk, me vlerë 42,951,011 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 9,547,365 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE “S..... F” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar me vlerë më të ulët të OE “A..... n” shpk (42,951,011-33,403,646) = 9,547,365 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Në procedurën e prokurimit me objekt: **“Rikonstrukcion i rrugëve kodër e kuqe (Konferenca e Bujanit+Ndoc Gjetja+impiani i shkarkimit të Bovillë”**, me fond limit 51,960,948 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S..... F” shpk, me vlerë 51,000,000 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet

të fondeve në vlerën 5,587,770 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE “S..... F” shpk minus (-) ofertën e s’kualifikuar me vlerë më të ulët të OE “B..... B” shpk (51,000,000- 45,412,230) = 5,587,770 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5. Në procedurën e prokurimit me objekt: “**Rikonstrukcion qendra shëndetësore Kamëz**”, me fond limit 69,894,608 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE “S... G” sh.p.k, me vlerë 52,768,516 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën 3,792,127 lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e OE padrejtësisht të kualifikuar dhe shpallur fitues “S...G” sh.p.k minus(-) ofertën me vlerë më të vogël të paraqitur nga BOE “K...a” sh.p.k & “K..... t” sh.p.k (52,768,516- 48,976,389) = 3,792,127 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6. Në procedurën e prokurimit me objekt “**Kryerja e Sherbimit të Pastrimit në Territorin e Komunës Paskuqan**”, (ish-Komuna Paskuqan), me fond limit 18,500,000 lekë, zhvilluar në vitin 2015, u konstatua se: KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “S..... a” shpk & “D..... v” shpk, me vlerë 17,928,738 lekë, pasi nuk ka plotësuar kërkesat e DST. Si pasojë, tenderi duhej anuluar dhe duhej zhvilluar procedurë e re, çka nuk ka ndodhur, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve në vlerën **1,401,363** lekë, të llogaritur si diferencë nga oferta e BOE “S..... a” shpk & “D..... v” shpk minus (-) ofertën padrejtësisht të s’kualifikuar të OE “E..... a” shpk (17,928,738 - 16,527,375) = 1,401,363 lekë. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 1, “Objekti dhe qëllimi”, pika 2, germa a, b, d dhe dh, dhe Neni 2 “Parimet e përzgjedhjes”, germa a, b dhe c, Neni 24 “Anulimi i një procedure prokurimi” dhe nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” (trajtuar në faqet 52-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave të kualifikimit dhe shpalljes fitues të operatorëve ekonomik për 6 procedura prokurimi të llogaritura si diferencë e vlerave të ofertave ekonomike në vlerën **35,092,429** lekë, mos përdorim me efektivitet, efikasitet në kushtet e mos plotësimit të kriterëve të miratuara në DST, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasojë me efekte negative të pamatshme.

Menjëherë

B.3 MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, u konstatua se nga Bashkia Kamëz, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme shtrënguese në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, nenet 70, 90, 91, 114, ligjit nr. 9482, datë 03.04.2010, “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, neni 23, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimi” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr. 140 datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore të bashkisë për vitin 2017”.

Totali i të ardhurave të munguara nga mos vjelja e tatim taksave vendore, është në shumën 336,898,800 lekë, nga të cilat:

- 49,781,264 lekë, debitorë për taksat dhe tarifatat vendore të pa paguara nga 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 subjekte të biznesit të madh (nga të cilat për vlerën 5,016,666 lekë, nga ish Komuna Paskuqan),
- 285,035,451 lekë, detyrime të pa arkëtuara nga taksat e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifatat përkatëse për 4,226 persona të pajisur me lejen e legalizimit, (nga të cilat për vlerën 5,016,666 lekë, nga ish Komuna Paskuqan),
- 2,082,685 lekë, 45 subjekte të cilat kanë ushtruar aktivitetin e tyre, pa qenë të regjistruara në QKB dhe nuk kanë paguar detyrimet vendore (Bashkia Kamëz, për 54 subjekte në vlerën 1,976,251 lekë, Njësia Administrative Paskuqan, për 10 subjekte në vlerën 106,434 lekë) (trajtuar më hollësisht në faqet 125-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Bashkia Kamëz nëpërmjet strukturave përkatëse, të marrë masa e nevojshme shtrënguese për vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale.

Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182, të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Menjëherë

C. MASA ADMINISTRATIVE

C. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit. Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), 6 punonjësve si më poshtë:**

- 1- S..... i**, me detyrë Përgjegjës i Njesisë Prokurimit, në cilësinë e anëtarit të NJHDT për shkelje në 6 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 1,2,3,4,5,6:
- 2- S..... a**, me detyrë Specialiste Njesisë Prokurimit, në cilësinë e anëtares së NJHDT për shkelje në 6 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 1,2,3,4,5,6:
- 3- F..... a**, me detyrë Specialist i Njesisë Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të NJHDT për shkelje në 3 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 2,3,4:
- 4- A..... i**, me detyrë Drejtor i Çështjeve Ligjore dhe Prokurimeve Publike, në cilësinë e anëtarit të KVO për shkelje në 3 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 5,6,7:
- 5- V..... j**, me detyrë N. Kryetar Bashkie, në cilësinë e anëtarit të KVO për shkelje në 3 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 5,6,7:
- 6- A..... e**, me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO për shkelje në 2 procedura prokurimi, respektivisht me numër rendor 5.

Në mënyrë të përmbledhur shkeljet, në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të LPP, në këto procedura prokurimi:

1. Në tenderin me objekt “*Ndërtim rruga OSBE, Kamëz 4*”, me fond limit 25,159,301 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: Njësia e Prokurimit nuk ka inventarizuar dosjen e tenderit në kundërshtim me

ligjin nr. 9154, datë 06.11.03, “Për Arkivat”. Gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me VKM 914, Neni 61 pika 2 paragrafi 2, për arsye se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, është kërkuar numri i fuqisë punëtore i mesatarisht 40 punonjës, janë kërkuar në mënyrë të paargumentuar kategoritë e licencave profesionale dhe një numër i madh inxhinierësh.

2. Në tenderin me objekt “**Blerje peme dekorative**”, me fond limit 20,833,333 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: Njësia e Prokurimit nuk ka inventarizuar dosjen e tenderit në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03, “Për Arkivat”. Gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me VKM 914, Neni 61 pika 2 paragrafi 2, për arsye se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuar me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht kriteret për numrin e fuqisë punëtore dhe stafin drejtues.

3. Në tenderin me objekt “**Ndërtim Rruga “Liria” vazhdim Frutikulturë**”, me fond limit 87,638,336 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: Njësia e Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me VKM 914, Neni 61 pika 2 paragrafi 2, për arsye se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuar me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht kriteret për numrin e fuqisë punëtore, licencat profesionale, numrin e inxhinierëve dhe mjeteve të kërkuar.

4. Në tenderin me objekt “**Ndërtim rrugë (Rr. Butrinti + Rr. Pashtriku + Rr. Saranda) në Laknas**”, me fond limit 20,168,437 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: Njësia e Prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 46 të LPP dhe me VKM 914, Neni 61 pika 2 paragrafi 2, për arsye se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuar me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre, konkretisht kriteret për numrin e fuqisë punëtore, licencat profesionale dhe numrin e inxhinierëve të kërkuar.

5. Në tenderin me objekt “**Rikonstrukcion qendra shëndetësore Kamëz**”, me fond limit 69,894,608 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: Njësia e Prokurimit nuk ka inventarizuar dosjen e tenderit në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.03, “Për Arkivat”. Gjithashtu ka vepruar në kundërshtim me VKM 914, Neni 61 pika 2 paragrafi 2, për arsye se kriteret e përdorura nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe nuk janë të argumentuar me hollësi mbi domosdoshmërinë e tyre. KVO, u konstatuar se tenderi duhej të ishte anuluar dhe të ishte zhvilluar procedurë e re pasi asnjë nga OE ekonomik nuk ka plotësuar kriteret e kualifikimit, çka nuk ka ndodhur, duke kualifikuar dhe shpallur padrejtësisht fitues OE “S..G” sh.p.k, në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 dhe 53 pika 3, të LPP, duke shkaktuar mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe efikasitet në vlerën 3,792,127 lekë.

6. Në tenderin me objekt “**Ndërtim rruga Paskuqan 2 Vreshtë vazhdim**”, me fond limit 30,273,425 lekë, zhvilluar në vitin 2016, u konstatua se: Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk plotësojnë kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë. KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues ofertën e paraqitur nga BOE “N.... i” sh.p.k & “N..... i” sh.p.k, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 dhe 53 pika 3, të LPP.

7. Në tenderin me objekt “**Ndërtim rruge Elez Isufi, Zanave, Burreli, Torini dhe Bicaj**”, me fond limit 33,433,087 lekë, zhvilluar në vitin 2017, u konstatua se: Asnjë nga ofertat e paraqitura nuk plotësojnë kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit, për rrjedhojë tenderi duhej anuluar, çka nuk është bërë. KVO padrejtësisht ka kualifikuar dhe shpallur fitues ofertën e paraqitur nga BOE “K..... n” shpk & “V..... E” shpk, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 46 dhe 53 pika 3, të LPP.

C.2. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Kamëz.

Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, nenit 12 Kreun III, neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3 Kreu II, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, i rekomandojmë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Kamëz, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur masën “**Dënimin me gjobë**”, për 1 mbikëqyrës punimesh, si më poshtë:

I. E..... a, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet:
a. "Ndërtim KUN Paskuqan 1 dhe Rruga Ibrahim Rrugova", me sipërmarrës punimesh OE "S..... F" sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **421,080 lekë pa tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt sipas kontratës nr. 380 prot datë 15.09.2016 të lidhur mes Titullarit të Autoritetit Kontraktor Bashkia Kamëz dhe OE "S..... F" Sh.p.k.

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-sëtë ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të nenit 58, "llojet e masave disiplinore" të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" dhe nenin 64 shkronjën **g**, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" **i rekomandojmë** Kryetarit së Bashkisë Kamëz, që ti kërkojë Komisionit disiplinortë fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për **14** punonjësit:

a-"Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj" e parashikuar në nenin 58, shkronja "b" **për 2 punonjësit** si më poshtë:

- 1-A..... **a**, me detyrë Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendor,
- 2- J..... **a**, me detyrë ish Përgjegjëse e Regjistrimit dhe Vlerësimit,

b."Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet" e parashikuar në nenin 58, shkronja "c" për 12 punonjësit e mëposhtëm:

- 1-F..... **u**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 2-A..... **u**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 3-E..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 4-K..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 5-I..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 6-H..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 7-V..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 8-F..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 9-E..... **i**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 10-G..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 11-E..... **i**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,
- 12-A..... **a**, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren.

Për sa:

-Ndër vite, kanë ushtruar aktivitetet 45 subjekte pa qenë të regjistruar në QKB, buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi i këtyre subjekteve, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 2,082,685 lekë.

-Në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 biznesit të madh, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 49,781,264 lekë.

-Për taksën e pasurisë dhe taksën e reklamës rezultuan diferenca në vlerën prej 729,754 lekë (taksë ndërtese 402,393 lekë, taksë trualli 16,861 lekë dhe taksë reklame 310,500 leke), e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.

-Diferenca nga mos përlllogaritja e saktë e tarifave vendore (pastrimit) në 27 raste për vitin 2016, në vlerën 440,000 lekë, në kundërshtim me tarifatat e miratuara nga VKB.

-Diferenca nga mos përlllogaritja e saktë e tarifave vendore (pastrimit+gjelbërimit) në 99 raste, për vitin 2017, në vlerën 965,000 lekë, në kundërshtim me VKB nr. 60, datë 21.12.2015, VKB nr. 140, datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore” i ndryshuar,

Veprimet e mos veprime në kundërshtim me ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, pika 7, neni 3, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 40, pika 1, neni 41, pika 1,2,3, të ligjit nr 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, nenet 90, 91 dhe neni 114, VKB nr.60, datë 21.12.2015, VKB nr.140, datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore” i ndryshuar.

D.2. Për punonjësit që marëdhëniet e punës rregullohen sipas kodit të punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të neni 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, **i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë** që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2015, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për 7 punonjësit e mëposhtëm:**

1-A..... a, me detyrë Kryeinspektori IMTV,

Për mos përmbushje të detyrimeve ligjore dhe mos zbatimin e plotë të kërkesave të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” i ndryshuar, neni 44, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar dhe dhe VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, *me pasojë mos arkëtimin e vlerës së gjobave të vendosura, të ardhura të munguara në vlerën 54,933,000 lekë për buxhetin e Bashkisë Kamëz.*

1-B..... a, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,

2-K.....a, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,

3-G.....i, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,

4-A.....j, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,

5-X..... a, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren,

6-H.....a, me detyrë Specialist i Taksave dhe Tarifave Vendore në Terren.

Për sa:

-Ndër vite, kanë ushtruar aktivitet 45 subjekte pa qenë të regjistruar në QKB, buxhetit të Bashkisë për periudhën objekt auditimi nga mos regjistrimi i këtyre subjekteve, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negativ në vlerën 2,082,685 lekë.

-Në fund të vitit 2017 rezultojnë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 201 subjekte të biznesit të vogël dhe 47 biznesit të madh, llogaritet mungesë të ardhurash me efekt negative në vlerën 49,781,264 lekë.

-Për taksën e pasurisë dhe taksën e reklamës rezultuan diferenca në vlerën prej 729,754 lekë (taksë ndërtese 402,393 lekë, taksë trualli 16,861 lekë dhe taksë reklame 310,500 leke), e cila përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Bashkisë Kamëz.

-Diferenca nga mos përlllogaritja e saktë e tarifave vendore (pastrimit) në 27 raste për vitin 2016, në vlerën 440,000 lekë, në kundërshtim me tarifatat e miratuara nga VKB.

-Diferenca nga mos përlllogaritja e saktë e tarifave vendore (pastrimit+gjelbërimit) në 99 raste, për vitin 2017, në vlerën 965,000 lekë, në kundërshtim me VKB nr. 60, datë 21.12.2015, VKB nr. 140, datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore” i ndryshuar,

Veprimet e mos veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 40, pika 1, neni 41, pika 1,2,3, nenet 90, 91, 114, VKB nr.60, datë 21.12.2015, VKB nr. 140, datë 23.11.2016 “Për miratimin e taksave e tarifave vendore” i ndryshuar.

E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Kamëz, Njësia e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

F. TË TJERA

F.1. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR

Për 2 ish punonjësit e mëposhtëm, nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara do të ishte kërkuar masë disiplinore, përkatësisht:

1-z. F..... a me detyrë ish Kryetar i Komunës Paskuqan,

2- z. A.....a me detyrë ish Përgjegjës i Zyrës së Financës Paskuqan.

Në rastin e fillimit të procedurave gjyqësore në funksion të zbatimit të këtij rekomandimit për “Masa për shpërblim dëmi”, nga ana e Bashkisë Kamëz, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R